



Prishtinë, 29 dhjetor 2011
Kodi i ZRRE-së: V_394_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Dispozitat e Nenit 12.1.20 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
3. Dispozitat e Nenit 7 të Ligjit për Energjinë,
4. Dispozitat e Nenit 6 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
5. Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 04.11.2011 për shqyrtimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2012 – 2021”

në seancën e mbajtur me datë 29 dhjetor 2011, nxori këtë:

VENDIM

Aprovohet “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2012 – 2021”

Arsyetim

ZRrE me datë 04.11.2011 ka pranuar kërkesën për shqyrtim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2012 – 2021” të KOSTT SH.A. Dokumenti ka qenë në diskutim publik dhe përveç ZRRE-së ka dhënë komente edhe KEK-u. Pas përfshirjes së pjesës më të madhe të komenteve në dokument, ZRrE vlerëson se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara dhe aprovon Planin Zhvillimor të Transmisionit 2012 – 2021 me vërejtjet si më poshtë:

- **Paket Projekti: “UNAZA 400kV Gjakovë – Prizren – Ferizaj”** – Për këtë projekt duhet pasur parasysh se është mjaft voluminoz dhe i kushtueshëm, atëherë konsiderojmë se duhet vlerësuar arsyeshmëria e investimit të tillë në vitet e ardhshme.
- **Projekti: “Linja e re 110 kV NS Peja 1 - NS Deçani”** - Meqenëse në vitin 2016 pritet të realizohet ri-vitalizimi i linjës 110 kV: L126/2 NS Peja 2- NS Deçan, si dhe linja L126/1 NS Gjakova 1 - NS Deçan është e ri-vitalizuar, është e nevojshme të bëhet vlerësimi i arsyeshmërisë së investimit të tillë në të ardhmen.
- **Projekti: “Linja e re 110 kV NS Peja 3 - NS Mitrovica 2”** - Meqë Mitrovica 2 do të jetë e lidhur përmes linjave të shkurta me Trepçën dhe Vallaqin që janë nyje mjaft të forta, e po ashtu në vitin 2017 pritet realizimi i Linjës së re 110 kV NS Peja 3- HC Ujmani, është e nevojshme të bëhet vlerësimi i arsyeshmërisë së investimit të tillë në vitet e ardhshme.
- Duhet të shikohet me kujdes ndikimi i **projekteve të KEK-ut në nivelin 110/x kV** e sidomos në frymën e kalimit të këtyre aseteve nga KEK-u te KOSTT-i.



Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE- së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Enver Halimi, Anëtar